



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2 dhe 79 të Ligjit Nr. . 03/L-051 për Aviacionin Civil,

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tej referuar si “Marrëveshja për HPEA”) në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes për HPEA për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë edhe ato të lidhura në emër të Kosovës nga UNMIK-u,

Me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave për certifikimin e ofruesve të shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës në përputhje me nenin 7 të Rregullores (KE) Nr. 550/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 10 marsit 2004 për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në Qiellin e Vetëm Evropian (Rregullorja e Ofritit të Shërbimeve) dhe Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 2096/2005 të 20 dhjetorit 2005 duke përcaktuar kërkesat e përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të navigimit.

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 12/2010**  
**PËR CERTIFIKIMIN E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGIMIT AJROR**

*Neni 1*

1.1 Kjo Rregullore definon termat dhe kushtet të cilat duhet të përmbushen nga Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror (OSHNA) që punojnë dhe janë të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe metodat e lëshimit të certifikatave të aftësive dhe privilegjeve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës të Kosovës, që vepron si Autoritet Mbikëqyrës Kombëtar (AMK), në procesin e certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të Ofruesve të SHNA.

1.2 Kërkesat e shkruara në këtë Rregullore nuk janë relevante për ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror ushtarak në lidhje me operacionet ushtarake dhe trajnimet ushtarake.

## Neni 2

2.1 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, aplikohen shprehjet dhe definicionet në vijim:

*Aviacioni i Përgjithshëm*: transporti civil ajror përveç atij të transportit komercial ajror ose që punon nga ajri;

*Hazardi*: Kërcënimi potencial: çdo situatë, ndodhi ose rrethanë e cila në kushte të veçanta mund të sjell deri te incidenti ose aksidenti;

*Risku*: Kombinimi i mundësive dhe shpeshhtësisë së ndodhive të incidenteve serioze dhe ndikimet në siguri;

*Autoriteti Mbikqyrës Kombëtar – AMK*: Autoriteti i cili mbikëqyrë punën e certifikimit të Ofruesve të SHNA, mbikëqyrë shërbimet e navigimit ajror që nënkupton mbikëqyrje të vazhdueshme për përmbushjen e disa kushteve të shkruara, dhe punëve të tjera në pajtim me këtë Rregullore. Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës të Kosovës (më tej referohet si “AAC”) është AMK për Republikën e Kosovës;

*Mbikëqyrja e Sigurisë*- AMK punon në pajtim me Rregulloren (KE) Nr. 1315/2007, dhe mbikëqyr Organizatat e Sigurisë të cilat merren me funksionimin e MRRTA ose MHA;

*Organizata Operuese* – Një organizatë që ofron shërbime inxhinierike dhe teknike që shërbejnë si mbështetje e shërbimeve të SHTA ose KNS, dhe e cila mund të jetë pjesë e Ofruesit të SHNA ose si person i pavarur juridik;

*Organizata e Pranuar* – Një organizatë e caktuar nga AMK për të kryer disa aktivitete mbikëqyrëse në emër të saj;

*Përshkrimi i Organizatës*- Dokumenti i cili përshkruan organizatën dhe modulën e punës së Ofruesit të SHNA;

*Veprimet Korrektuese*- Hapat e ndërmarra për eliminimin e çfarëdo shkaktari të mos-pajtueshmërive ndaj kërkesave të shkruara;

*Certifikata e aftësive* – *Certifikata e Ofruesve të shërbimeve të navigimit ajror*: Është një dokument i lëshuar nga AMK, dhe konfirmon se Ofruesi i SHNA është në pajtueshmëri me rregullat relevante për të ofruar një ose më shumë shërbime të navigimit ajror;

*Rregullorja e KE Nr. 550/2004*- Përcakton kornizën për krijimin e Qiellit të Vetëm Evropian;

*Rregullorja KE Nr. 2096/2005- Përcakton Kërkesat e Përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror;*

*Rregullorja KE Nr. 1315/2007- Për mbikëqyrjen e sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe amandamenton Rregulloren (KE) Nr. 2096/2005;*

*Aplikacioni për Certifikim – Forma për Ofruesin e SHNA e cila udhëzon AMK-në me qëllimin final të lëshimit të Certifikatës;*

*Kërkesat e Përbashkëta – Kërkesat të cilat duhet të përmbushen nga Ofruesit e SHNA (bazuar në Rregulloren e KE Nr. 2096/2005);*

- a) *Kërkesat e Përgjithshme:* Kërkesat të cilat duhet të përmbushen nga të gjithë Ofruesit e SHNA pa ndonjë lidhje ndaj ndonjërit shërbim që ata ofrojnë (duke u bazuar në Rregulloren e KE Nr. 2096/2005, neni 3 dhe Aneksi 1);
- b) *Kërkesat e Veçanta:* Kërkesat të cilat duhet të plotësohen nga Ofruesit e cilitdo shërbim në navigimin ajror (duke u bazuar në rregulloren e KE Nr. 2096/2005, neni 3, dhe Anekset 2, 3, 4 dhe 5);

2.2 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, aplikohen shkurtesat në vijim:

*AMK - Autoriteti Mbikëqyrës Kombëtar*

*OSHNA – Ofruesi i Shërbimeve të Navigimit Ajror*

*MTA – Menaxhimi i Trafikut Ajror*

*MRRTA –Menaxhimi i Rrjedhës së Trafikut Ajror*

*SHTA – Shërbimet e Trafikut Ajror*

*SHIA – Shërbimet Informative Aeronautike*

*KNS – Komunikimi, Navigimi, Survejimi*

*SHME – Shërbimet Meteorologjike*

*MHA – Menaxhimi i Hapësirës Ajrore*

*EKRRS - Kërkesat Rregullative të Sigurisë Eurocontrol*

### *Neni 3*

Një Ofrues i Shërbimeve të Navigimit (SHNA) duhet të ofroj shërbimet e navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, vetëm nëse ai Ofrues posedon paraprakisht Certifikatën për ofrimin e shërbimeve të tilla.

### *Neni 4*

Pavarësisht nga Neni 3, Ofruesit e SHNA ushtarak në Republikën e Kosovës dhe / ose në shërbim të Mbrojtjes Ajrore mund të ofrojnë shërbime SHTA për Trafikun e Përgjithshëm Ajror në pajtueshmëri me Rregulloren (KE) 550/2004 Neni 6 (5) pa poseduar paraprakisht certifikatën për ofrimin e shërbimeve të tilla.

#### *Neni 5*

Çdo shërbim i ofruar i navigimit Ajror duhet të jetë në pajtim me termat e certifikatës.

#### *Neni 6*

6.1 Një Ofrues i SHNA duhet të informoj AAC-në përbrenda 120 ditëve para datës së planifikuar për dorëzimin e kërkesave për marrje të Certifikatës.

6.2 Pas pranimit të njoftimit paraprak, përcaktuar në paragrafin 1, AAC duhet të konfirmoj planin për certifikim dhe ta përcjellë atë tek Ofruesi i SHNA brenda 30 ditësh, së bashku me listën kontrolluese për përputhshmërinë me Kërkesat e Përbashkëta.

6.3 Ofruesi i SHNA dorëzon në AAC aplikacionin për marrjen e certifikatës brenda 30 ditësh nga data e pranimit të planit për certifikim, ashtu siç është definuar në paragrafin 2.

#### *Neni 7*

7.1 Një Ofrues i SHNA, i cili përcaktohet që të mos përfitoj nga ofrimi i shërbimeve ndërkufitare, mund të aplikojë në AAC për certifikatën e cila është e kufizuar vetëm për hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e Republikës së Kosovës.

7.2 Në mënyrë që të bëjë një kërkesë të tillë, një Ofrues i SHNA duhet të ofroj shërbimet ose të planifikon t'i ofroj ato shërbime vetëm në lidhje me një ose më shumë kategori si në vijim:

- a) aviacioni të përgjithshëm;
- b) punë ajrore;
- c) transport komercial ajror i kufizuar për avionët me masë më të vogël se 10 tonelata të peshës maksimale për ngritje ose me më pak se 20 ulëse për pasagjer;
- d) transport komercial ajror me më pak se 10,000 lëvizje për vit, pavarësisht peshës maksimale për ngritje dhe numrit të ulëseve për pasagjer, 'lëvizjet' fillojnë së numëruari si shumë e përgjithshme e ngritjeve dhe aterimeve dhe të kalkuluara nga mesatarja e tre viteve të fundit.

7.3 Në mënyrë që të bëjë një aplikim të tillë, një ofrues i shërbimeve të navigimit ajror që nuk është ofrues i shërbimeve të trafikut ajror, duhet që të ketë një qarkullim vjetor prej EUR 1.000.000 ose më pak në lidhje me shërbimet që i ofron ose që planifikon t'i ofroj.

7.4 Në mënyrë që të bëjë një aplikim të tillë një aplikues i cili ofron shërbime informuese të aeroportit për fluturime duhet të operojë rregullisht në jo më shumë se në një pozitë pune në cilindo aeroport.

*Neni 8*

Certifikimi i AAC-së për ofrimin e shërbimeve të kushtëzohet me pajtueshmërinë e Ofruesit të SHNA dhe njërive të tij me Kërkesat e Përgjithshme të aplikueshme për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror të përcaktuara me Rregulloren e Komisionit (KE) 2096/2005.

*Neni 9*

Pavarësisht nga Neni 8 i kësaj Rregulloreje, certifikimi i AAC-së për ofrimin e shërbimeve të kufizuara nën një aplikacion në pajtim me nenin 7 të kësaj Rregulloreje, duhet të përfshijë përjashtimet e veçanta nga përputhja me Kërkesat e Përbashkëta, ashtu siç janë lejuar me nenin 4 të Rregullores së Komisionit (KE) 2096/2005.

*Neni 10*

AAC duhet, para se të lëshoj certifikatën për ofrimin e shërbimeve, të kryej mbikëqyrjen e Ofruesit të SHNA dhe / ose njësitit(eve) në përputhshmëri me kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 1315/2007 dhe "Manualin e Procedurave të Mbikëqyrjes së Sigurisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror" të AAC-së. Një mbikëqyrje e tillë do të përfshijë auditimin e Ofruesit të SHNA dhe njërive të tij.

*Neni 11*

Ofruesi(t) i SHNA që aplikon për certifikim duhet, së bashku me aplikacion, të ofroj edhe dokumentet e specifikuar në nenin 13 të Rregullores dhe çfarëdo dokumenti tjetër që kërkohet nga AAC dhe të lehtësoj dhe bashkëpunoj me auditimet dhe inspektionet ashtu siç kërkohet.

*Neni 12*

Një certifikim për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror duhet të ketë të specifikuar afatin e caktuar kohor të vlefshmërisë dhe t'iu nënshtrohet disa kushteve të veçanta ashtu siç AAC e konsideron të arsyeshme.

*Neni 13*

Një Ofrues i SHNA duhet t'i dorëzojë AAC-së (dhe të mirëmbajë duke dorëzuar çdo amendament për aq kohë sa Ofruesi i SHNA është i Certifikuar) një përshkrim të

organizatës që përmban informatat si në vijim:

- a) Një deklaratë të nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv apo ekuivalent që konfirmon se organizata dhe çdo dokumentacion i referuar shoqërues definojnë përputhshmërinë aktuale dhe në vazhdimësi, të organizatës me të gjitha kërkesat e apilkueshme dhe pajtohet që t'i ofrojë AAC-së çfarëdo informate për vlerësimin e përshkrimit;
- b) Politikën e sigurisë së organizatës në pajtim me direktivat e Kërkesave të Përbashkëta;
- c) Titujt e pozitave dhe emrat e menaxhmentit të lartë;
- d) Llogaridhënien dhe përgjegjësitë e këtyre menaxherëve të lartë në lidhje me implementimin e Kërkesave të Përbashkëta përfshirë:
  - i. Përshkrimin e plotë të funksionit të menaxhimit të sigurisë të identifikuar në organizatë, me përgjegjësi për zhvillimin dhe menaxhimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë;
  - ii. Llogaridhëniet dhe përgjegjësitë, si dhe angazhimet për të siguruar se menaxhmenti i lartë i organizatës është aktivisht i përfshirë në menaxhimin e sigurisë;
- e) Një strukturë organizative që tregon linjën e përgjegjësive të menaxhmentit në fushat e mbuluara nga Kërkesat e Përbashkëta;
- f) Një përshkrim të përgjithshëm të resurseve njerëzore;
- g) Një përshkrim të përgjithshëm të objekteve dhe pajisjeve të organizatës;
- h) Fushëveprimin e shërbimeve që do të ofrohen nën këtë certifikatë;
- i) Procedurën për amendamentimin e përshkrimit dhe të njoftimit të AAC-së për çdo ndryshim;

#### *Neni 14*

14.1 Një Ofrues i SHNA duhet të ketë të vendosur dhe të mirëmbajë gjatë tërë kohës sa është i i certifikuar, një përshkrim të kompletuar se si organizata i përmbushë dhe si do të vazhdojë t'i përmbushë Kërkesat e Përbashkëta të cilat mund të përfshijnë referenca specifike për ose dorëzimin e disa ose të gjitha dokumenteve në vijim:

- a) Manualin e Menaxhimit të Sigurisë;

- b) Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë (përfshirë procedurat e veçanta për secilën njësi);
- c) Kutinë e Sigurisë për secilën njësi (nëse ka);
- d) Manualin e Operimit të SHTA për secilën njësi;
- e) Trajnimin e kontrollorëve të trafikut ajror dhe procesin e mirëmbajtjes së kompetencave që kërkohen me Rregulloren e AAC Nr. 04/2008 për Licencimin e KTA;
- f) Trajnimin e personelit inxhinjerek dhe teknik, procesi i kualifikimit dhe mirëmbajtjes së kompetencave që kërkohet me Rregulloren e Komisionit (KE) 2096/2005;
- g) Sigurimin se personeli është i trajnuar dhe është kompetent në mënyrë adekuate për punën që kërkohet prej tyre ta bëjnë.
- h) Dokumentacionin e garantimit të Sigurisë që përfshin:
  - i. informata për ndryshimet e ndërlidhura me sigurinë në secilën njësi;
  - ii. dokumentacionin në lidhje me ndryshimet e procedurave të SHTA (udhëzime shtesë ose të përkohshme etj.);
  - iii. Vlerësimet e Sigurisë dhe Analiza e Rreziqeve të ndërlidhura me ndryshimet në operim.
  - iv. Raportet hetimore të brendshme të sigurisë të ndërlidhura me raportet e ndodhive ose të ndërmarrura si rezultat i ndodhive relevante për siguri të raportuara përmes një procesi të brendshëm të raportimit;
  - v. Procesverbalet e takimeve në të cilat janë diskutuar çështjet e ndërlidhura me sigurinë (p.sh. komitetet teknike ose inxhinjerieke të KTA, ose Grupet Punuese për Menaxhimin e Sigurisë, nëse grupe të tilla janë themeluar);
  - vi. Raportet e brendshme e analizave të sigurisë ose shqyrtimet së bashku me të dhënat për veprimet e ndërmarrura për të adresuar rekomandimet që kanë rezultuar;
  - vii. Raportet e auditimeve të brendshme për SMS për përputhshmërinë ose efektivitetin.
- i) Sistemin e Sigurimit të Cilësisë ;

- j) Manualin e Menaxhimit të Sigurisë;
- k) Planin Biznesor pesë (5) vjeçar dhe Planin Vjetor;
- l) Raportin Vjetor.

*Neni 15*

Ofruesit e SHNA duhet të dorëzojnë aplikacion për marrjen e Certifikatës, jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

*Neni 16*

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 18 nëntor 2010.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtore i Përgjithshëm